Nr. 11-BD/2025
Prishtinë: 18.03.2025

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.12 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhnierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUDHËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 18.03.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

1. Për miratimin e programit vjetor të Odës sipas listës bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

*Vendimi i dërgohet:*

- *Komisionit Mbikqyrës.*
- *Anëtarëve Themelues të Odës.*
- *Arkivit të OIRK-së.*

<u>Bordi Drejtues i OIRK-së:</u>

1. **Arsim Rapuca**
   Kryetar i OIRK-së ____________________
2. **Mimoza Shahini**
   Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
3. **Kadri Morina**
   Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
4. **Afrim Demiri**
   Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
5. **Nebi Pllana**
   Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
6. **Bujar Jupaj**
   Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________
7. **Sami Kolgeci**
   Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së ____________________

**Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)**

**Plani vjetor i punës për vitin 2025**

1. Rexhistrimi i Odës së inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK).
2. Hapja e llogarisë bankare të OIRK-së.
3. Inventarizimi i Zyreve si dhe paisja e tyre me paisje elektronike si: kompjuter, printer si dhe paisje tjera të nevojshme.
4. Formimi i komisioneve vlerësuese dhe komisioneve tjera.
5. Formimi i administrates, zgjedhja e drejtorit ekzekutiv dhe zyrtarëve të administratës.
6. Krijimi i Web faqes së Odës.
7. Dizajnimi i llogos së Odës.
8. Trajtimi i aplikacioneve që janë në proces për licencim.
9. Trajtimi i aplikacioneve të reja për licencim për pjesën e mbetur të vitit.
10. Shënimi i ditës botërore së Inxhinierëve, 4Mars.
11. Përgaditja dhe miratimi i programit për edukim të vazhdueshëm të anëtarëve të licencuar të Odës.
12. Takime pune me Odat e rajonit dhe mundësitë e marrëveshjeve të bashkëpunimit.
13. Themelimi i grupeve punuese, këshillave profesionale apo grupeve të ekspertëve për nevoja të Odës.
14. Analiza dhe mundësia e përfshirjes në Odë të drejtimeve tjera inxhinierike si dhe trajtimi i ankesave të disa dretjimeve inxhinierike.
15. Përfaqësimi i Odës në komisionet për projektligjet që kanë të bëjnë me fushën e ndërtimit.
16. Ndarja e çmimeve dhe mirënjohjeve për anëtarët e Odës.
17. Përzgjedhja e kompanisë së sigurimit për sigurimin e përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar.
18. Mbajtja e mbledhjeve të Kuvendit si dhe informimi anetarëve të Kuvendit për planin vjetor të punës.
19. Krahasimi i ligjit të Odës së OIRK dhe OARK me ligjet e Odave të vendeve të rajonit për mundësitë e lidhjeve të marrëveshjeve.
20. Shqyrtimi i rregullores për njohjen e licencave të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës.
21. Rregullimi i qmimoreve të shërbimeve inxhinierike në bashkëpunim me Odën e Arkitektëve të Republikës së Kosovës (OARK).
22. Në fund të vitit 2025, analiza për mundësinë e pavarësimit të plotë të Odës në pajtim me ligjin.